



FORENSIC ENGINEERING ALBANIA SH.P.K

Adresa: Rr "Sulejman Delvina", Pallati Nr. 10, Shkalla 37, Kati 2^{te}, Tirana - Albania,

Web: <http://www.fea.al/>, email: info@fea.al, Tel/Fax 042209091

Tiranë më 02/08/2021

PROJEKT TEKNOLOGJIK

IMPIANTI I FURNIZIMIT ME NAFTË DHE

BENZINË

POROSITI

Subjekti: KAST-OIL Sh.p.k

Adresa: Rruga lidhëse Maminas-Autostrada TR-DR

NIPT: L 41405002 B

PROJEKTOI

FORENSIC ENGINEERING ALBANIA SH.P.K

LICENCE N.6891/1

Dr. Ing. Alfred HASANAJ

MSc. Ing. Darlin HIDA



PËRMBAJTJA

1. PËRSHKRIM RRETH PROJEKTIT TEKNOLOGJIK.....	3
2. VENDOSJA E PIKËS SË SHITJES SË KARBURANTEVE.....	3
3. TEKNOLOGJIA.....	4
4. PJESA E PËRGJITHSHME DHE TRANSPORTI	6
5. FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET	7
6. FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE NDËRLIDHJA	7
7. MBROJTJA E OBJEKTIT	8
8. REKOMANDIME	9
9. PËRSHKRIM RRETH PROJEKTIT TEKNOLOGJIK GLN	9
10. NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR GAZIN	10
11. KËRKESA TË PËRGJITHSHME.....	10
12. CILËSIT E GAZIT DHE RREZIKSHMËRIA E TIJ	11
13. VETITË FIZIKE TË GAZIT	12
14. TABELA ME VETITË FIZIKE TË GAZIT	13
15. AKSESORËT E REZERVUARIT TË GLN.....	13
16. MBROJTJA NGA SHKARKIMET ATMOSFERIKE	13
17. MBROJTJA NGA ZJARRI	14



1. PËRSHKRIM RRETH PROJEKTIT TEKNOLOGJIK NAFTE DHE BENZINE

Projekti teknologjik "Impiant i furnizimit me Naftë, Benzine dhe GLN" ka parashikuar furnizimin me Naftë dhe Benzine të subjektin "Kast-Oil Shpk" i cili ndodhet në Rruga lidhëse Maminas-Autostrada TR-DR . Për hartimin e projektit teknologjik është marrë në konsideratë:

- 1) Ligji nr 32/2016 datë 24.03.2016 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion
- 2) Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"
- 3) Urdhër nr. 128, datë 08.04.2016 "Për miratimin e procedurave për kontrollin Teknik "
- 4) Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- 5) Ligji nr.8450, datë 24.2.1999 "për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre".
- 6) Vendim i Këshillit të Ministrave nr.1062, datë 23.12.2015, "Për miratimin e rregullit teknik "Për pajisjet dhe bashkësitë nën presion".
- 7) Urdhër nr. 184, datë 05.07.2005, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës "Për kushtet dhe normat e projektimit të impianteve, instalimeve dhe pajisjeve që shërbejnë për depozitimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Në projektin e objektit përfshihen:

- a) Skema teknologjike, planimetria e objektit, skema e lidhjes etj;
- b) Furnizimi me energji elektrike për ndriçimin e brendshëm dhe të jashtëm.
- c) Mbrojtja e objektit nga rënia nën tension, rrymat elektrostatische, nga shkarkimet atmosferike si dhe ajo kundra zjarrit.
- d) Projekti nga ana ndërtimore i mjediseve të shërbimit si dhe ai i tendës do të realizohet nga grupi i projekteve ndërtimore.

1.1. Vendosja e pikës së shitjes së karburanteve

Pika e furnizimit me karburant, u tha edhe më sipër, ndodhet në Maminas, duke plotësuar të gjitha kërkesat, përfshirë dhe ato urbanistike për një destinacion të tillë, ndikon në gjallërimin e infrastrukturës përkatëse në shërbim të vetë shoqërisë.

